



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 437/Prot
1

Tiranë, më 11.02.2025

V E N D I M

Nr. 4, datë 11.02.2025

“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE, SIPAS KATEGORIVE TË INDIVIDËVE QË PLOTËSOJNË KRITERET E PRANIMIT NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE OSE NË NJË PROGRAM TË STUDIMEVE PROFESIONALE, QË PËRJASHTOHEN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025 (faza e dytë)”

Bordi i Administrimit, mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale në pamundësi financiare për të mbuluar tarifat vjetore të shkollimit”, i ndryshuar me VKM Nr. 779, datë 26.12.2018, VKM Nr. 40, datë 23.01.2019, VKM Nr. 251, datë 27.03.2020, “Për një ndryshim në Vendimin Nr. 269, datë 29.03.2017” si dhe referuar kërkesës së Administratorit të UBT-së me Nr. 432 Prot., datë 30.01.2025, në mbledhjen e tij të datës 11.02.2025,

V E N D O S I:

1. Të miratojë listën e studentëve, sipas kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2024-2025 (faza e dytë) (sipas tabelës bashkëlidhur).
 2. Efektet financiare të këtij vendimi (për 50 studentë që plotësojnë kriteret) janë në vlerën **1,389,000 (një milion e treqind e tetëdhjetë e nëntë mijë) lekë.**
 3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori i UBT-së.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Arta DOLLANI

Kryetar

Sokol DURO

Anëtar

Blerina DUKA

Anëtar

Donika KËRÇINI

Anëtar

Florian NURCE

Anëtar

Altin PRENGA

Anëtar

Albert KOPALI

Anëtar

Konceptoi: N. Ndoci